



Pranuar / Dorezuar Prilimno/Prilato Received/Delivary	22-08-2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHCK	4875/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.602/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.602/2022 të datës 06.07.2022, të parashtruar nga ankuesit me adresë banimi në Komunë të Klinës, kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.602/2022 e datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Klinës dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative par kompensimin e pagës së ankuesit sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim Akt-in e Emërimit Nr.01-112-1486/22 të datës 11.01.2022 si dhe në mënyrë retroaktive të kompensoj diferencën e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë (7.0) duke filluar nga data e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-NR.117-1168/2022 të datës 11.01.2022.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Klinës, më datë 06.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3946/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Zyrës së Personelit të Komunës së Klinës të datës 05.07.2022, për shkak të mos

zbatimit të ndryshimit dhe plotësimit të Akt Emërimit me Nr. 01-112-1486/22 të datës 11.01.2022 dhe mos realizmin e pagës konform këtij akti.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Klinës. Ndërsa Këshilli, me datë 12.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3946/2022 të datës 06.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01NR.117-1168/2022 të datës 11.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Klinës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër 01.Nr.112-1486/2022 të datës 11.01.2022; E-mail i datës 05.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4680/2022 të datës 12.08.2022; Kërkesën e datës 18.01.2022 të Drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Klinës drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Listën e pagave për muajin Maj, Qeshor, Korrik-2022 për ankuesin; enëpunësen civile [redacted] Listën e pagave për muajin Qershor-2022, për nëpunësen civile [redacted] Kërkesën e datës 18.01.2022 të Drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Klinës drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Formularin e datës 18.01.2022 të shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit; Formularin e datës 27.09.2021 të shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit Nr.01-112-1168/22 të datës 11.01.2022 rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Klinës në pozitën "Përkthyes i Gjuhës Serbe dhe anasjelltas" në Drejtorinë për Administratë, me koeficient gjashtë (6) të pagës. Të njëjtit me Vendimin me numër 01-Nr.117-1168/2022 të datës 11.01.2022 nga Kryetari i Komunës së Klinës i është aprovuar ngritja e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7), me qëllim që nëpunësi civil të realizoj të drejtën në pagë në përputhje me punën dhe detyrat e punës si dhe praktiken në nivel vendi pasi që për pozitën e tillë parashihet koeficienti 7.0, dhe konform këtij vendimi ankuesi i është lëshuar Ndryshimi dhe plotësim Akti i Emërimit me numër 01-Nr.112-1486/22, duke përcaktuar koeficient 7.0 të pagës.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen se ankuesi me datë 05.07.2022 i është drejtuar me shkrim Zyrës së Personelit të Komunës së Klinës, më shkresë/kërkesë për ekzekutimin e pagesës sipas koeficientit 7.0 të paraparë me ndryshim plotësimin e Akt Emërimit me Nr.01-112-1486/22 të datës 11.01.2022. Ndërsa kjo e fundit me datë 05.07.2022 në përgjigje të ankuesit e njofton të njëjtin se Zyra e Personelit ka ndërmarr të gjitha veprimet procedurale lidhur me ekzekutimin e pagesës mirëpo ministria përkatëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 05.07.2022 të Zyrës së Personelit në Komunën e Klinës, ka parashtruar ankesë me 06.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës për

shkak të mos zbatimit të ndryshimit dhe plotësimit të Akt Emërimit me Nr.01-112-1486/22 të datës 11.01.2022 dhe mos realizimin e pagës konform këtij akti.

Në përgjigjen në ankesë, Organi i punësimit deklaron së Komuna e Klinës përmes Zyrës së Personelit disa herë radhazi ka bërë përpjekje tek Thesari i Kosovës lidhur me realizimin dhe harmonizimin e koeficienteve konform Akt emërimeve, pasi që Komuna posedon dhe ka ndarë mjete buxhetore mirëpo nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Thesari i Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me ketë neni 3 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, që në rastin konkret bazuar në dispozitat ligjore është konsatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës ju garantohet dhe duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë.

Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....* andaj, bazuar në dispozitat ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji gjen së organi i punësimit në këtë rast Komuna e Klinës ka ndërmarr të veprimet nevojshme për harmonizimin e koeficientit të ankuesit gjegjësisht janë nxjerr aktet administrative me të cilat ankuesit i është njohur e drejta e nivelizimit të pagës, janë planifikuar mjete buxhetore si dhe është bërë kërkesë në ministrinë përgjegjëse për ekzekutimin e aktit për nivelizimin e koeficientit të pagës, mirëpo që kjo e fundit nuk ka ekzekutuar kërkesën në fjalë, andaj mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Kolegji me të drejtë vlerëson së ankuesi në kuptim të realizimit të së drejtës së pagës vazhdon të trajtohet në mënyrë me pak të favorshme se sa nëpunësit civilë të cilët ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës në institucionet tjera publike, rrjedhimisht nisur nga ekzistimi i këtyre fakteve rezulton së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të njëjta të punës, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*

Për me tepër bazuar në gjendjen faktike si më lartë, Kolegji vlerëson së mos kompensimi i pagës së ankuesit sipas aktit për nivelizimin e koeficientit të pagës bie ndesh edhe me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë konkretisht nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët

Publikë, me të cilin është theksuar se : *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, e mbi këto arsye, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe të ligjshme.*

Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për kompensimin e pagës së ankuesit sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim Aktin e Emërimit Nr.01-112-1486/22 të datës 11.01.2022 si dhe në mënyrë retroaktive të kompensoj diferencën e koeficientit të pagës nga gjashtë (6.0) në shtatë (7.0) duke filluar nga data e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-NR.112-117/1168/2022 të datës 11.01.2022.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.602/2022.

Zyle Millaku -GOJNOVCI


Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

